



**REPUBLIKA E KOSOVËS-KOMUNA VUSHTRRI**

**DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT**



10 Nr. 569 /2021

Datë: 28.06.2021

Bazuar në Ligjin për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr.04/L-032, Udhëzimin Administrativ Nr.22/2013 “Numri maksimal i nxënësve për klasë dhe raporti mësimdhënës nxënës” dhe Kushtet dhe kriterët për regjistrim. Si dhe në pajtim me udhëzimet përkatëse të shpallura nga MASHT:

**DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT NË VUSHTRRI SHPALL**

**KONKURS**

**PËR REGJISTRIMIN E NXËNËSVE NË KLASËN E DHJETË (10) TË GJIMNAZEVE DHE TË SHKOLLAVE**

**PROFESIONALE PËR VITI SHKOLLOR 2021/22**

**Planifikimi për regjistrim të nxënësve në klasën e dhjetë (X) për Gjimnazin në Vushtri:**

SHKOLLA	Drejtimi	Nr. i Paraleleve	Nr. Nxënësve në një paralele	Gjithsej për drejtim
Gjimnazi "Eqrem Çabej" Vushtri	Natyror	6	24	144
	Shoqëroro – Gjuhësor	6	24	144
Gjithsej:		12		288

**Planifikimi për regjistrim të nxënësve në klasën e dhjetë (X) për shkolla profesionale-  
Vushtrri**

<b>Shkolla</b>	<b>Drejtimi</b>	<b>Profili</b>	<b>Nr. i paraleve</b>	<b>Nr.i nx.</b>	<b>Viti i shkollimit</b>	
SHMT "Lutfi Musiqi" Vushtrri	Makineri	Përpunim i Drurit	1	24	2+1	
		Automekanik	1	24	2+1	
		Operator i Makinave dhe Dirigjim Kompjuterik	1	24	2+1	
		Inst.i Ngrohjes Klimatizimit dhe Uësjellsit	2	48	2+1	
		Metalpunues	2	48	2+1	
	Elektroteknikë	Mekatronikë	1	24	2+1	
		Instalues Elektrik	2	48	2+1	
	Elektroteknikë	Teknik i Sistemeve të TI	2	48	2+1	
		Teknik i Infotmatikës së Biznesit	2	48	2+1	
			<b>Gjithsej -"Lutfi Musiqi" Vushtrri</b>	<b>14</b>	<b>336</b>	
	SH.M.P " Bahri Haxha" Vushtrri	Kimi-Teknologji	Laborant i kimisë	1	24	2+1
			Teknologji e riciklimit	1	24	2+1
			Përpunim i metaleve	1	24	2+1
		Gjeodezi	Arkitekturë	1	24	2+1
Ekonomi		Kuzhinjer	1	24	2+1	
		Kontabilist dhe Tatime	1	24	2+1	
		Shpedicion dhe Logjistikë	1	24	2+1	
Bujqësi		Tregtarë me pakicë dhe shumicë	1	24	2+1	
		Agrobiznes	2	48	2+1	
		Hortikulturë	1	24	2+1	
		Mbrojtja e Bimëve	1	24	2+1	
		Teknologjia Ushqimore	1	24	2+1	
Tekstil		Konfeksion	1	24	2+1	
		<b>Gjithsej: SHMP" Bahri Haxha" Vushtrri</b>	<b>14</b>	<b>336</b>		
		<b>GJITHSEJ</b>	<b>28</b>	<b>672</b>		

## **Dokumentet e nevojshme për konkurrim**

Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10-të në gjimnaze dhe shkolla profesionale, duhet të paraqesin këto dokumente: - Fletëparaqitjen (e cila merret në shkollën në të cilën konkurron) - Dëftesën origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) dhe - Certifikatën e lindjes.

## **Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt**

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, të gjimnazeve dhe të shkollave profesionale, për vitin shkollor 2021/22, mund të konkurojnë kandidatët të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç.

Nxënësit, të cilët e kanë mbaruar klasën e nëntë (IX) jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin e dëftesave në MASHT dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

Konkursin dhe kriteret e detajuara për secilin drejtim i gjeni të publikuara në shkollat përkatëse dhe në web faqen e Komunës së Vushtrrisë; <https://kk.rks-gov.net/vushtrri/>

## **Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve**

-Paraqitja e dokumenteve për gjimnaze dhe shkolla profesionale për vitin shkollor 2021/2022, bëhet më datë : **28, 29, 30** qershor 2021 duke filluar nga ora 8:00-16:00.

-Shpallja e rezultateve më **01.07.2021**

-Kthimi i dokumenteve për nxënësit, të cilët nuk janë pranuar do të bëhet prej 01.07.2021 deri me 03.07.2021. duke filluar nga ora 8:00-16:00.

## **AFATI I ANKESAVE`**

Kandidati i refuzuar dhe i cili dyshon se i janë shkelur kriteret e regjistrimit ka të drejt, brenda 24 orëve, nga koha e shpalljes së rezultateve t'i paraqes ankesë drejtorisë së shkollës.

Vërejtje: Mos ankesa në afatin zyrtar, në shkollën përkatëse, nënkupton humbje e të drejtës për ankesë në shkollën e dytë në Drejtorinë e Arsimit (DKA) apo në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT). DKA dhe MASHT nuk shqyrton asnjë ankesë nëse ajo paraprakisht nuk është shqyrtuar nga komisioni përkatës i shkollës.